



## Vërtetimet

Informatat në vijim iu referohen vërtetimeve të kopjeve dhe të nënshkrimeve. Informata mbi legalizimin dhe vërtetimin e çertifikatave zyrtare të Republikës së Kosovës gjeni në fletinformacionet „Legalizimi“, gjegjësisht „Vërtetimi i çertifikatave“.

### 1. Vërtetimi i kopjeve

Nëse ju duhet të paraqitni dokumente, si dëftesa, dokumente të identifikimit, apo çertifikata të gjendjes civile për t'i përdorur ato në Gjermani, ndërsa dëshironi t'i mbani origjinalet, ambasada mund t'i vërtetojë kopjet e këtyre dokumenteve.

#### Si mund të vërtetohen kopjet?

Për shkak të kufizimeve aktuale lidhur me pandeminë covid-19, aktualisht janë në dispozicion shumë pak termine për paraqitje personale. Nëse dëshironi, kërkesat për vërtetim të kopjeve mund të paraqiten edhe me shkrim. Për këtë luteni, që origjinalin e certifikates (certifikatave) /dokumentit (dokumenteve) së bashku me kërkesën, një kopje të pasaportës / letërnjoftimit tuaj si dhe kopjet, të cilat duhet të vërtetohen t'i dërgoni në Ambasadën Gjermane në Prishtinë (Deutsche Botschaft / Ambasada Gjermane, Rr. Azem Jashanica 66, 10 000 Prishtina, Kosovo) ose këto t'i dorëzoni në një zarf të mbyllur tek porta (hyrja kryesore) e ambasadës. Luteni të fusni origjinalet dhe aq kopje sa duhet të vërtetohen. Origjinalet nuk guxojnë të jenë të plastifikuara. Kopjet nuk guxojnë të jenë të ngjitura mes vete dhe duhet të jenë të tërësisht të kopjuara dhe mirë të lexueshme. Luteni që të mos paraqisni foto të shtypura të dokumenteve, por vetëm kopjet e origjinaleve. Kopjet, të cilat janë vërtetuar paraprakisht nga një noter kosovar, nuk mund të vërtetohen. Luteni të keni kujdes, që të fotokopjohet faqja e përparme e dokumentit dhe ajo e pasme, nese në dokumentet në faqen e pasme kanë ndonjë shënim (apo vulë). Luteni të keni parasysh që kopjet e përkthimeve zakonisht nuk mund të vërtetohen.

Me vërtetim të kopjes vërtetohet vetëm saktësia e pëprthshmërisë së kopjes me origjinalin, mirëpo ajo nuk i referohet përmbajtjes së çertifikatës.

#### Sa kushton vërtetimi i kopjes?

Tarifa për vërtetimin e një kopje, sipas Rregullores për Shpenzime jashtë vendit për një dokument deri në 10 faqe në alfabet latin është 10,- euro dhe 1,- euro për secilën faqe pasuese. Kopjet tjera të paraqitura do të bashkohen nga ana jonë në NJE dokument. Nëse kjo nuk dëshirohet, luteni të na njohtoni në kërkesë. Tarifat e lartcekura do të aplikohen sërish në bazë të ndarjes së dëshiruar.

Poashtu duhet paguar edhe 3,00 euro (5,00 euro nëse ka shumë dokumente dhe formate të mëdha) shtesë për shpenzime të transportit për kthim të dokumenteve. Ekziston edhe

mundësia të bashkangjitet një zarf i adresuar dhe i parapaguar i DHL-së, me të cilin do të kthehen pastaj dokumentet. Për adresim dhe parapagim të saktë, përgjegjësinë e bart vetë aplikuesi. Nëqoftëse duhet vërtetuar kopja e një pasaporte/letërnjoftimi atëherë për kthimin e pasaportës/letërnjoftimit dhe kopjes së vërtetuar patjetër duhet që kërkesës t'i bashkangjitetnjë zarf i parapaguar i zbrazët i DHL-së.

**Udhëzim me rëndësi: Pagesa e tarifës bëhet vetëm përmes transferit bankar. Luteni që kërkesës me shkrim të mos i bashkangjisni as para e as qeqe.** Pas pranimit dhe verifikimit të dokumenteve tuaja, ju do të pranoni nga ambasada një email me të dhënat e bankës, shumën e tarifës që duhet paguar dhe numrin e regjistrimit, të cilin duhet ta cekni në transfer. Ju lusim që të mos bëni transfer para se të kërkohej kjo nga Ju, sepse pagesat pa numer të regjistrimit nuk mund të përpunohen.

Si do të më kthehen dokumentet?

Kthimi i dokumenteve bëhet në parim përmes postës, tërheqja personale e dokumenteve të dërguara me shkrim tani nuk është e mundur për shkak të kufizimeve aktuale lidhur me pandeminë covid-19.

## **2.Vërtetimi i nënshkrimeve**

Nëpunësit konsullorë mund të vërtetojnë një nënshkrim, apo shenjë dore, nëse ato bëhen, ose njihen para nëpunësit konsullor. Për këtë arsye është e domosdoshme paraqitja personale e personit, nënshkrimi apo shenjat e gishtërinjve të të cilit mëtohet të vërtetohen.

Në rastin e vërtetimit të nënshkrimit kontrollohet dhe vërtetohet vetëm identiteti i nënshkruesit. Me këtë rast personi nuk informohet lidhur me rëndësisinë dhe pasojat e deklaratës. Megjithatë nëpunësi konsullor obligohet – rëndom përmes një bisedeje të shkurtër – që të sigurohet që nënshkruesi është i vetëdijshëm, çfarë nënshkruan. Ambasada në këto raste as bën përkthimin me shkrim as aty për aty përkthimin verbal të deklaratës së paraqitur në një gjuhë të huaj.

Për llogaritjen e tarifës sipas Rregullores së Tarifave jashtë vendit vlera e transaksionit ligjor definohet në përputhje me veprimin zyrtar përkatës (në rast të transaksioneve të patundshmërisë, p.sh. çmimi i blerjes, në rast të shoqërive kapitale, kapitali themelor). Vlera e tarifës është 20,- euro deri më së shumti 250,- euro.

Për vërtetim të nënshkrimit, luteni të paraqitni dokumentet në vijim:

1. Deklaratën që duhet nënshkruar;
2. Dëshminë lidhur me vlerën e transaksionit përkatës. Për deklaratë të miratimit nevojitet një kopje e kontratës, për vërtetime të regjistrimit tregtar, kopjet e vendimeve përkatëse të shoqërisë, apo çertifikatat e themelimit të noterizuar;
3. Pasaportën ose letërnjoftimin tuaj valid.

Shembuj për vërtetime të nënshkrimeve:

- Deklaratë e miratimit: Deklaratë me anë të së cilës një person, i cili është përfaqësuar gjatë lidhjes së një kontrate në Gjermani dhe i cili e miraton kontratën në mënyrë retrospektive
- Autorizimet me anë të të cilave dhënësi i autorizimit nuk obligohet në mënyrë të parevokueshme
- Kërkesat për vërtetime nga regjistri tregtar
- Parashtrimi i kërkesës për çertifikatë policore
- Deklaratë për heqje dorë nga trashëgimia.

Si mund të vërtetohet nënshkrimi im?

Për vërtetim të nënshkrimit duhet të paraqiteni personalisht dhe të nënshkruani para nëpunësit konsullor / nëpunëses konsullore. Luteni të keni kujdes që në termin t'i merrni të gjitha dokumentet e kompletuara.

**Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.**